

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 19.01.2023 me adres Berat, Corovode, L.E.Caka, ndertes me siperfaqe 81 m2, me Nr Pasurie 12/5,ZK. 14/20,Volum. 16, Faqe 153, bazuar ne vendimin e asamblese se ortakut te vetem te shoqerise ,u perpilua kontrata e shitjes kuotave me palet si vijon:

SHITESI: **Frida Buzali**, qytetare shqiptare, lindur ne Gjorm,Vlore dhe banues ne Tirane, me datelindje 14.09.1986, identifikuar me letër njoftim nr personal.I65914095R

BLERESI : **z.Hysen Buzali**, qytetar shqiptar, lindur ne Potom,Skrapar dhe banues ne Tirane, me

20.02.1985, identifikuar me letër njoftim nr personal.I50220169L;

Palet e mesiperme kryen redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash ne vazhdim :

Shitesi Frida Buzali,eshte zoterues i 1(nje) kuote ose perkatesisht i 100 % te kapitalit te shoqerise Pharma Lab shpk per vleren 1,800,000 euro, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar prane QKB-se, me date themelimi 13/10/2020 dhe date regjistrimi 14/10/2020 me NIPT M022140011.

Kapitali i shoqerise eshte ne shumen 1,800,000 euro ose kundervlera ne leke, i zoteruar nga ortaku i vetem, si me poshte :

znj.Frida Buzali 1(nje) kuote 100% per shumen 1,800,000 euro ose ekuivalenti ne leke.

Objekti i kontrates

Asambleja e ortakut te vetem te shoqerise me vendimin e saj dhe bazuar ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",i ndryshuar, Statutin e Shoqerise, etje,ka vendosur:

Te pranoj propozimin e ortakut te vetem znj.Frida Buzali per transferimin nepermjet shitjes te 100% te kapitalit te shoqerise,te perbere nga 1(nje) kuote ne vleren nominale 1,800,000 (nje milion e teteqinde mije) euro,ne emer dhe per emer te z.Hysen Buzali si perfituese, kjo ne vijim te kalimit te kuotave dhe mardhenieve ne tetor 2021, po midis dy paleve :

Ishte ,Ortake i shoqerise dhe zoterues i kuotes;



Znj. Frida Buzali 1(nje) kuote 100% per shumen 1,800,000 euro,ose ekuivalenti ne leke.

Behen ortak i vetem dhe zoterues i kuotes;

z. Hysen Buzali 1(nje) kuote 100% per shumen 1,800,000 euro,ose ekuivalenti ne leke

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se 1(nje) kuote,me vleren nominale 1,800,000 (nje milion e teteqinde mije) euro, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut i vetem znj.Frida Buzali dhe qe



transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut te ri shoqerise z. Hysen Buzali , eshte per vleren 10,000(dhjete mije) euro ose kundervleren ne leke, kjo ne marveshje midis paleve dhe pasi te jete verifikuar gjendja pasurore e shoqerise dhe derdhja e kapitalit te regjistruar. Bleresi ne marveshje me shitesin, deklarojne se dokumentimi i likujdimit te vleres se plote, behet vetem nepermjet llogarise bankare dhe palet nuk kane asnje pretendim tjeter.

Garancite

Shitesi deklaroi dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga cdo barre apo pretendim tjeter ligjor. Shitesi pranon qe menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate te behet kalimi i kuotave ne dhe per llogari te bleresit.


Heqje dore nga te drejtat dhe detyrimet

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale, se heq dore nga cdo e drejte dhe detyrime qe i takojne mbi kuoten dhe pjesen e kapitalit te shitur, keto te drejta dhe detyrime pasketej,jane pergjegjesi e ortakut te vetem te shoqerise, znj.Frida Buzali , e cila zoteron 1(nje) kuote ose 100% te kapitalit te shoqerise per vleren 1,800,000 euro, ose kundervleren ne leke.

Kjo kontrate u hartua ne 3(tre) ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht ate sipas ligjit.

SHITESI

Frida Buzali



BLERESI

Hysen Buzali

